VENDIM
Nr. 202, datë 27.9.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "M.C. ENERGJI GOJAN" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1845/5 prot., datë 23.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'M.C. Energji Gojan' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "M.C. Energji Gojan" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1845 prot., datë 30.8.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan", në pellgun ujëmbledhës të lumit "Fani i Madh" në zonën e Gojan-Gjegjanit, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 mw. Gjithashtu, në këtë shkresë ajo ka kërkuar nga ERE që të marrë në konsideratë pagesën e kryer nga shoqëria në datën 10.10.2023, për të mos rënduar financiarisht shoqërinë. Kjo pagesë përkon me aplikimin e shoqërisë për të cilin Bordi i ERE-s është shprehur me vendimin nr. 374, datë 26.12.2023.

- Rezulton se shoqëria e ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat "a" dhe "b"; për pikën 1.2, germat: "a", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germën "c"; për pikën 2.1, germat: "a", "b", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "M.C. Energji GoJAN" sh.p.k.:

- ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën e koncesionit të formës BOT me nr. 2515 rep., nr. 1181 kol., datë 6.11.2017, "Kontratë koncesioni e formës 'BOT' (ndërtim-operim-transferim) për objektin 'Dhënie me koncesion të hidrocentralit Gojan'", të ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit nr. 2 rep., nr. 2/3 kol., datë 3.1.2019 dhe me kontratën shtesë nr. 1990 rep., nr. 1465 kol., datë 7.12.2022;

- është pajisur me lejen e përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor nr. 1/2 prot., datë 20.4.2021, dhënë nga Këshillit i Basenit Ujor Mat, me afat vlefshmërie sipas kontratës koncesionare;

- është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 17.10.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtim i HEC 'Gojan'", për fuqinë 15 mw.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.1. Formati i aplikimit, sipas përcaktimeve të shtojcës 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje:

- germa "c": aplikuesi duhet të saktësojë deklarimin e tij, në lidhje me refuzimin më parë të një licence nga ERE;

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa "b": aplikuesi duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k.;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa "a": aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa "b": aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës mbi mbështetjen financiare për realizimin e projektit, sipas vlerës që rezulton nga kontrata me MIE-n dhe sipas parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit;

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës:

2.1. Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- germa "c": (miratimin e operatorit të rrjetit (OST sh.a. ose OSSH sh.a.) për lidhjen e centralit/centraleve me rrjetin elektrik), aplikuesi duhet të depozitojë miratimin e OST sh.a. për lidhjen e hidrocentralit me rrjetin e transmetimit.

- Gjithashtu, aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse kanë nisur punimet për ndërtimin e veprës, si dhe të depozitojë informacion/dokumentacion, në lidhje me zbatimin e afateve për ndërtimin dhe vënien në operim të centralit, referuar përcaktimeve të kontratës së nënshkruar me MIE-n.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gojan", në pellgun ujëmbledhës të lumit "Fani i Madh,", në zonën e Gojan-Gjegjanit, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 15 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "M.C. Energji Gojan" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti